

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр.58/00 и 44/02) и член 30 од Законот за основно образование Службен весник на РСМ, бр. 161 од 5.8.2019 година, министерот за образование и наука донесе наставна програма по Албански јазик за VII (седмо) одделение на деветгодишното основно образование, избран предмет за учениците од другите заедници.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



PROGRAMI MËSIMOR

**GJUHË SHQIPE (LËNDË ZGJEDHORE)
PËR KLASËN VII TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR
PËR NXËNËSIT E BASHKËSIVE TË TJERA**

Shkup, 2019

Emri i lëndës	Gjuhë shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera
Statusi i programit mësimor	Lëndë zgjedhore
Klasa	VII
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	2 orë në javë /72 orë në vit
Qëllimet e programit mësimor	<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përforcojë njohuritë dhe shkathtësitë e përvetësuara në klasën e gjashtë dhe të përvetësojë njohuri dhe shkathtësi të reja të komunikimit; - aftësimi i nxënësit për të zhvilluar një bashkëbisedim (dialog) që lidhet me situatat e përditshmërisë; - aftësimi për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për t'u shprehur me fjali lidhur me tërësi të caktuara tematike; - përvetësimi i strukturave më të shpeshta gjuhësore të shqipes; - kultivimi i shprehisë për përdorimin e fjalorit dhe burimeve të tjera të diturive; - aftësimi i mëtejme për komunikim gojor dhe me shkrim në jetën e përditshme; - pasurimi i fjalorit përmes leximit të teksteve joletrare si dhe të teksteve letrare; - aftësimi për të kuptuar përmbajtjen e teksteve, për të shpjeguar atë që lexon etj.; - nxitja e kreativitetit në të shprehur, të menduarit logjik, kritik e krijues.
Fusha programore (njësitë modulare) si pjesë përbërëse të programit mësimor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pasurimi i fjalorit (me leximin e teksteve joletrare dhe letrare); 2. Përdorimi i drejtë i gjuhës; 3. Të shprehurit dhe krijimtaria.
Kushtet hapësinore dhe materiale-teknike	Mësimi realizohet në mësonjëtoare ose në kabinet, ndërsa në raste të veçanta shoqërohet edhe me aktivitete përcjellëse që e zëvendësojnë vendin e mbajtjes së mësimit (institucionet e kulturës, institucionet shkencore, biblioteka, kinoteka, medioteka etj.).
Normativi për kuadrin arsimor	Lëndën Gjuhë shqipe në arsimin fillor mund ta realizojnë mësimdhënësit që kanë kryer: Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS.

Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
1. PASURIMI I FJALORIT (ME LEXIMIN E TEKSTEVE JOLETRARE DHE LETRARE)			
<ul style="list-style-type: none"> - të lexojë, të shkruajë, të bëjë pyetje e të përgjigjet, të flasë e të përkthejë tekste që lidhen me veprimtarinë e shkollës, aktivitetet sportive, jetën e fëmijëve...; familjen, obligimet dhe profesionet ...; mbi karakteristikat e qytetit: rrugët, bulevardet, sheshet, parqet, lagjet, sjelljet e njerëzve, higjienën; mbi fshatin: natyrën, prodhimet bujqësore, blegtorale etj.; 	<p>Tekste joletrare (lexim, shkrim, pyetje-përgjigje, përkthim tekstesh joletrare me temat e shënuara më lart)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime për të pasuruar fondin e fjalëve që kanë mësuar në klasën e gjashtë. - Do të ishte mirë të shfrytëzoheshin materiale audiovizuale nga Interneti e YouTube-ja që lidhen me tema të caktuara mësimore, si p.sh.: të mësojmë së bashku, fjalë të ndryshme shqip, numrat shqip, ngjyrat, kafshët shtëpiake, kopshti zoologjik për fëmijë etj. Metodat: metoda e komunikimit, metoda audiovizuale, metoda e demonstrimit, e krahasimit. 	<p>Di të lexojë, të shkruajë, të flasë dhe të shprehet (me shkrim e me gojë) për temat e parapara për klasën e gjashtë e për këtë klasë.</p> <p>Përdor më shumë fjalë e di t'i lidhë mendimet në fjali më mirë sesa në klasën e gjashtë.</p> <p>Përpiqet të kuptojë e të mësojë fjalë të reja duke lexuar e dëgjuar tekste joletrare.</p> <p>Shkruan vështrim të shkurtër për ndonjë tekst joletrar.</p>
<ul style="list-style-type: none"> - të lexojë, të shpjegojë përmbajtjen dhe të vlerësojë tekste letrare për fëmijë (prozë, poezi, dramë); - të lexojë e recitojë poezi lirike; - të lexojë ndonjë pjesë drame dhe të bëjnë dramatizimin e fragmenteve të lehta të përzgjedhura; 	<p>Tekste letrare (lexim, shpjegim, komentim tekstesh letrare për fëmijë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime me tekste të zgjedhura nga librat ose burimet tjera të përshtatshme për nxënësit. - Lexohen poezi të lehta e të drejtpërdrejta (të pangarkuara me figura letrare). - Ushtrime me tekste të përzgjedhura e të qarta për nxënësit. - Të përzgjidhen e të ndiqen nga interneti YouTube-ja përralla e tregime për fëmijë, filma 	<p>Lexon, kupton dhe interpreton tekste letrare për fëmijë.</p> <p>Analizon personazhet kryesore; Bisedon për disa veçori të pjesës dramatike dhe të shfaqjes në teatrin e fëmijëve;</p> <p>Shikon, kupton filmin për fëmijë dhe tregon përmbajtjen;</p> <p>Tregon dhe ritregon fabulën;</p> <p>Lexon fjalë të urta dhe komenton përmbajtjen;</p> <p>Lexon, kupton e reciton vjersha; Shkruan vështrim të shkurtër për tekstin letrar dhe jo letrar.</p>

		vizatimorë për fëmijë (në gjuhën shqipe), këngë shqipe për fëmijë etj.	
Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
2. PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS			
- të dallojë dhe të përdorë drejt emrat në gjini, në trajtën e pashquar e në trajtën e shquar, në numrin njëjës e në shumës);	Emri (gjinia, trajta dhe numri)	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për të dalluar e përdorur drejt emrat në gjini, trajtë dhe numër). Metodat: ndërvepruese (interaktive), e demonstrimit etj.	Dallon dhe përdor drejt emrat në gjini, në trajtën e pashquar e në trajtën e shquar, në numrin njëjës e në shumës).
- do të aftësohet të njohë, t'i shkruajë dhe t'i shqiptojë drejt numrat deri në një mijë;	Numrat (drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i tyre)	- Ushtrime për të identifikuar, shkruar dhe shqiptuar drejt numrat deri në një mijë.	I dallon, i shkruan dhe i shqipton drejt numrat prej 1-1000.
- të njohë, t'i shkruajë dhe t'i shqiptojë drejt mbiemrat;	Mbiemri (mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; përshtatja e mbiemrit me emrin)	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të mbiemrave.	Dallon mbiemrin dhe llojet e tij: mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e panyjshëm. Përshtat siç duhet mbiemrin me emrin.
- të përdorë drejt përemrat;	Përemri (llojet dhe përdorimi i drejtë i tyre)	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të përemrave.	Dallon përemrin dhe llojet e tij: përemrin vektor, përemrin dëftor, pyetës etj., si dhe i përdor drejt.
- të përdorë drejt disa folje më të shpeshta në tri kohët kryesore në mënyrën dëftore;	Folja (koha e tashme, e shkuara dhe e ardhmja e mënyrës dëftore)	- Ushtrime për dallimin dhe përdorimin e drejtë të foljeve që kanë përdorim më të dendur në tri kohët kryesore në mënyrën dëftore.	Dallon foljen dhe përdor drejt atë: foljet ndihmëse <i>kam</i> dhe <i>jam</i> . Dallon dhe përdor drejt foljet në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme të

			mënyrës dëftore.
- të përdorë drejt shkronjën e madhe;	Përdorimi i shkronjave të mëdha	- Diktim teskti për të përvetësuar përdorimin e shkronjave të mëdha.	Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim të fjalisë dhe kur shkruan emrat e përveçëm.
- t'i lexojë pa gabime tingujt karakteristikë të gjuhës shqipe (ata tinguj që nuk i kanë nxënësit në gjuhën e tyre amtare);	Leximi me zë	- Ushtrime me qëllim të evitimit të gabimeve gjatë leximit; - Ushtrime për drejtshqiptimin e tingujve dhe fjalëve karakteristike të shqipes, me përdorim të audio dhe video kasetave...	Lexon rrjedhshëm me zë, duke shqiptuar drejt fjalët, rrokjet e tingujt.
- të flasë dhe të lexojë me diksionin e duhur tekste letrare dhe joletrare.	Diksioni	- Ushtrime për përmirësimin e mëtejshëm të leximit, pas leximeve paraprake shprehëse të arsimit ose pas përcjelljes së materialeve audiovizuale me ligjërim artistik.	Flet dhe lexon me diksionin e duhur tekste letrare dhe joletrare (diksioni është mënyra e shqiptimit të fjalëve, të rrokjeve e të tingujve kur flasim, kur këndojmë ose kur recitojmë).
<p>Sqarim: Përmbajtjet mësimore të fushës programore <i>Përdorimi i drejtë i gjuhës</i> realizohen nëpërmjet përmbajtjeve të njësive modulare të tërësive tematike pasurimi i fjalorit dhe të shprehurit dhe krijimtaria, që do të thotë se ato janë integruar në njësitë komunikative për të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Përmbajtjet mësimore të <i>Gramatikës</i> në program janë shënuar si tema më vete, por realizimi i tyre nuk nënkupton interpretim metagjuhësor, d.m.th. shpjegim ose përkufizim gjuhësor. Aftësitë gjuhësore të përfshira në këto përmbajtje mësimore nxënësit i përvetësojnë në mënyrë pragmatike – nëpërmjet të dëgjuarit, të vërejturit, shqiptimit, kopjimit, përsëritjes, të treguarit, të biseduarit etj.</p>			
Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
3. TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA			
- të zhvillojë një bashkëbisedim të shkurtër që lidhet me jetën e punën e tij, të familjes, të shokëve e shoqeve etj.;	Bashkëbisedim (dialog)	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për të zhvilluar një bashkëbisedim të shkurtër. Metodat: metoda e komunikimit, metoda ndërvepruese	Di të zhvillojë një bashkëbisedim të shkurtër. Di të parashtojë pyetje dhe të përgjigjet në pyetjen që e bën bashkëbiseduesi.

		(interaktive), metoda audiovizuale, e demonstrimit, e përkthimit etj.	
- të bisedojë për temat e parapara;	Bisedë	- Ushtrime për të folur e shkruar për frymorë e sende, për tregimin e veprimeve dhe mënyrën e kryerjes së veprimeve; vetitë e frymorëve dhe sendeve etj.	Kupton bisedat, flet dhe shkruan për temat e parapara për këtë klasë
- të tregojë gjëra që lidhen me përjetimet vetjake..., me ndihmën e fotografive, teksteve, diafilmave etj.;	Tregim	- Nxënësit punojnë në grupe; formulojnë idetë e tyre dhe i shënojnë në fletore...; zgjedhin formulimet më të mira për t'i prezentuar në nivel të grupeve...	Tregon shkurtimisht ndonjë ngjarje, rast, dëshirë, parapëlqim ose pasi ka lexuar ndonjë tregim e rrëfen atë.
- të ritregojë me pak fjalë përmbajtjet e dëgjuara (të lexuara nga arsimtari, prindi, radioja apo televizori...);	Ritregim	- Ushtrimet e të shprehurit lidhur me ritregimin e ndonjë ngjarjeje të përjetuar a të dëgjuar, të ndodhur në shkollë a gjetiu.	Di të ritregojë ndonjë ngjarje të përjetuar a të dëgjuar në shkollë a gjetiu.
- të përshkruajë frymorë, sende dhe dukuri nga temat e parapara ose personazhe veprash letrare, aktorë filmash, ndonjë personalitet apo të përshkruajë shkurtimisht çfarëdo qoftë...;	Përshkrim	- Ushtrime për përshkrimin e sendeve, dukurive dhe frymorëve... - Ushtrime për përshkrimin e ndonjë personazhi të ndonjë vepreje letrare, aktori në ndonjë film, të ndonjë personaliteti të shquar...	Përshkruajnë frymorë, sende dhe dukuri nga temat e parapara... Di të përshkruajë ndonjë personazh të ndonjë vepreje letrare, aktori në ndonjë film, të ndonjë personaliteti të shquar...
- formën e folur të ligjërimit ta shndërrojë në formë të shkruar;	Diktim	- Diktimitë tekstesh të shkurtra për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit (identifikimi i përbërjes tingullore të fjalëve dhe shënimit të tyre me shkronja, përdorimi i shenjave të pikësimit etj.).	Di të shkruajë me saktësi fjalët e fjalitë që dëgjon.
- të përkthejë nga gjuha e vet amtare në shqip fjalë, shprehje e fjali të shkurtra.	Përkthim	- Ushtrime përkthimi fjalësh, shprehjesh e fjalish të thjeshta.	Përkthen fjalë e fjali të thjeshta nga gjuha amtare në gjuhën shqipe.

Vlerësimi i arritjes së nxënësve	<p>Vlerësimi i rezultateve është i detyrueshëm dhe bëhet sipas normave ligjore. Përparimi dhe vlerësimi i nxënësve ndiqet rregullisht dhe kryhet në vazhdimësi gjatë orëve mësimore, me qëllim që vlerësimi t'u shërbejë nxënësve për të ditur gjendjen reale të diturive të veta si dhe do të stimulohen për përmirësimin dhe thellimin e përhershëm të tyre. Në përputhje me natyrën e programit të lëndës së Gjuhës shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera, vlerësimi mund të bëhet nëpërmjet formës me gojë dhe me shkrim ose me ndonjë formë tjetër.</p> <p>Instrumenti gojor i vlerësimit përfshin përgjigjet që jep nxënësi në pyetjet e bëra, parashtrimin e pyetjeve (për nxënësit) dhe zhvillimin e bashkëbisedimeve të shkurtra.</p> <p>Instrumenti shkrimor parapëlqen ushtrime për nxënien dhe përvetësimin e alfabetit të shqipes (shkronjave të shtypit dhe të dorës).</p> <p>Vlerësimi bëhet në një temë të caktuar, gjatë tremujorshit, gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor.</p> <p>Për nxënësit që nuk i përvetësojnë në nivelin e mjaftueshëm njohuritë, detyrimisht organizohet mësim plotësues.</p> <p>Nxënësi vlerësohet me notë numerike.</p>
Literatura dhe burime të tjera	<p>Libri shkollor i miratuar nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës (libër me vizatime, doracak mësimdhënës për zbatimin e aktiviteteve programore, material për lexim dhe shkrim fillestar të shkronjave të shtypit dhe të dorës), tabelë interaktive, Internet (softuera arsimorë, ueb-faqe), aplikacione mobile etj.</p>
Institucioni/ bartësi i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit (BZhA)
Потпис и датум на донесување на наставната програма	<p>бр. 12-11216/3 28.10.2019 година</p> <p style="text-align: right;">МИНИСТЕР, ср. Dr. Arbër Ademi</p>
Датум на ревизија	